

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DoAL Textil” Sh.p.k.**



Sot më datë 01.04.2019 në Tiranë, u paraqit pala e mëposhtme:

- Znj. Dorisa Alikaj, qytetare shqiptare, e lindur në Berat, Shqipëri, me 07.05.1984, me vendbanim në Bulevardi Zhanë D’Ark, Nd. 107, H19, Ap. 22, Njësia Administrative nr. 3, Tiranë, Shqipëri, me letërnjoftim nr. 029009872 dhe nr. personal I45507021D,

e cila ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “**Shoqëria**”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë “**Shtojca 1**”).

**Neni 1
EMËRTIMI**

Emërtimi i Shoqërisë është “DoAL Textil” Sh.p.k.

**Neni 2
SELIA**

Selia e Shoqërisë është në Rr. Jordan Misja, pasuria nr. 1/387, zona kadastrale 8330, Njësia Bashkiake nr.9, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4
OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 4.2. Shoqëria mund të kryejë aktivitet fason në përpunimin aktiv, krjimin, qepjen, prerjen, paketimin, prodhimin, shitjen dhe blerjen e prodhimeve tekstile. Punime dhe shërbime të ndryshme në lidhje me shërbimet fason dhe të tjera shërbime të ngjashme, duke bashkëpunuar edhe me palë të treta.

- 4.3. Import dhe eksport.
- 4.4. Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.
- 4.5. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5
KAPITALI THEMELTAR

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Leke 100 (njëqind).
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e gjitha e nënshkruar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë, përcaktuar në nenin 7 (shtatë) të Statutit.

Neni 6
KONTRIBUTET

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Znj. Dorisa Alikaj ofron një kontribut në para të barabartë me Leke 100 (njëqind), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelimin e sipër.
- 6.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
- Znj. Dorisa Alikaj i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 100 (njëqind), që i korrespondon 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7
TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8




ADMINISTRIMI


- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:
- Znj. Dorisa Alikaj, qytetare shqiptare, e lindur në Berat, Shqipëri, me 07.05.1984, me vendbanim në Bulevardi Zhanë D'Ark, Nd. 107, H19, Ap. 22, Njësia Administrative nr. 3, Tiranë, Shqipëri, me letërnjoftim nr. 029009872 dhe nr. personal I45507021D.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9 GJUHA

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM


Z. Dorisa Alikaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE
DEGA VENDORE TIRANE.

Nr.927Rep.

Nr.412.Kol



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 01/04/2019 (dymije e nentembdhjete), perpara meje noteres publike **Marsela Elmazaj**, me seli ne Tirane, B.L.V."Bajram Curri", u paraqiten personalisht :

Znj. **Dorisa Alikaj**, qytetare shqiptare, e lindur në Berat, Shqipëri, me 07.05.1984, me vendbanim në Bulevardi Zhanë D'Ark, Nd. 107, H19, Ap. 22, Njësia Administrative nr. 3, Tiranë, Shqipëri, me letërnjoftim nr. 029009872 dhe nr. personal I45507021D, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

E cila me vullnetin e saj të lire, të plote dhe të sinqerte, me cilesine e ortakes themelues te shoqerise "**DoAL Textil**" Sh.p.k, ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, "**Akt-Themelimi**" sa me siper dhe pasi e lexuan e nenshkruan pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale ne kete zyre para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 110, date 20/12/2018. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE
Marsela Elmazaj